

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit - Nr. i AP: **NPL KASTRIOTI -26-1034-1-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me materiale elektrik për nevoja të ndërmarrjes-Ri-tender**

### A N K E S Ë

#### Identifikimi i ankuesit\*

**OE “Item EL SH.P.K.”**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**Rr. “Burim Vitia” p.n.**

*(Adresa)*

**Prishtinë**

*(Vendi)*

**10000**

*(Kodi postar)*

**+383 49497382**

*(Numri Telefonit)*

*(Numri i Faks-it)*

**Ahmet Vitia**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**itemshpk@gmail.com**

*(Adresa elektronike)*



**26.04.2026**

*(Data e parashtrim të ankesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].*

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **“Furnizim me materiale elektrik për nevoja të ndërmarrjes-Ri-tender”**.

Njoftimi për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit është bërë më datë 06.03.2026

Dorëzimi dhe hapja e tenderëve është bërë me datë 16.03.2026.

Me datë 10.04.2026 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë, me datë 15.04.2026 jemi drejtuar me Kërkesë për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues.

AK me date 16.04.2026 e ka refuzua kërkesën tone andaj te pakënaqur me këtë vendim po i drejtohem OSHP-se me ankesë.

Kriteri i vlerësimit ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët**.

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja e tenderëve është bërë me datë 16.03.2026. Në procesverbalin e hapjes publike nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje.

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

#### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Me datë 10.04.2026 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë, me datë 15.04.2026 jemi drejtuar me Kërkesë për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues.

AK me date 16.04.2026 e ka refuzua kërkesën tone andaj te pakënaqur me këtë vendim po i drejtohem OSHP-se me ankesë.

#### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së,
2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,
3. AK ka shkelur nenit 59 të LPP-së,
4. AK ka shkelur nenit 61 të LPP-së dhe 41 të RRPP-001/2022,
5. AK ka shkelur nenin 65 të LPP-së
6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së,
7. AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**1. AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së** pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit në përgjithësi, nuk ka luajtur rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive. Neni 1 shumë qartë e thotë se:

*Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.*

Kjo nuk është respektuar aspak në rastin konkret sepse OE që AK e ka shpallur fitues edhe pse posedon çmimin më të ulët se ne, brenda listës së çmimeve ka ofruar çmime spekuluese që për AK do të kushtoj shumë me tepër se sa kontrata jonë. Përpos kësaj ky OE nuk ka arritur të sqaroj çmimet e kontestuara nga AK dhe se deklarata e ofruar nga ky OE bie ndesh plotësisht me nenin 41.8 dhe 41.9 të RRPP-001/2022. Ky OE gjithashtu ka edhe detyrime të pashlyera ndaj ATK gjë të shihet nga vërtetimi i dorëzuar para se të shpallej fitues. Sipas ligjit dhe interpretimit të KRPP-së kur OE ka marrëveshje për shlyerje të borxheve, duhet dorëzuar edhe marrëveshjen. Ne kemi dyshuar se marrëveshja me ATK është pas publikimit të njoftimit për kontratë andaj kemi pretenduar se këtë tenderues e bënë të papërgjegjshëm. Edhe pse marrëveshjen me ATK, AK na e prezanton tek pas kërkesës tonë për rishqyrtim,

nëse ajo marrëveshje nuk është pranuar nga OE me rastin e dorëzimit të dokumenteve të përshtatshme, AK është dashur ta eliminoj atë si të papërgjegjshëm. AK nuk ka sqaruar se kur e ka pranuar marrëveshjen e tillë për çka ne dyshojmë se ajo është futë në material pas kërkesës tonë për rishqyrtim në mënyrë të pa ligjshme. Ky OE nuk kishte ofruar as dëshmitë për kontratat e përfunduara ashtu siç ishin kërkuar andaj kjo e forcon akoma më shumë konstatimin se ky OE është i papërgjegjshëm.

Nga kjo shihet se AK në mënyrë jo transparente po tenton të shpërblej me kontratë një OE që realisht është i papërgjegjshëm pasi që ky OE nuk ka ofruar si duhet as informatat e kërkuara shtesë për çmimet e kontestuara nga AK. Për këto mangësi dhe shkelje tjera të AK-së do ju njohim edhe në vazhdim.

Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe 6 të LPP-së duke mos vlerësuar tenderët në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me kërkesat e ligjit nga çka shkaktohet shpenzim i parasë publike në mënyrë jo efektive, jo transparente dhe jo ekonomike.

**2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së** pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit në mënyrë të barabartë. E themi këtë sepse edhe përkundër faktit që OE i shpallur fitues nuk ka ofruar sqarime të mjaftueshme dhe bindëse për çmimet e kontestuara nga AK, edhe pse nuk e ka dorëzuar me kohë marrëveshjen me ATK-në e gjithashtu edhe pse nuk ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara për përfundim të suksesshëm të kontratave nga natyra e ngjashme ashtu siç ishin kërkuar në FDT, prapë AK e ka favorizuar dukshëm duke e shpallur edhe fitues. OE i shpallur fitues posedon çmimin më të ulët se ne por ka mangësi në tenderin e tij duke potencuar veçanërisht çmimet spekuluese të pa sqaruara si duhet prandaj mos vlerësimi i tenderëve në mënyrë të drejtë dhe favorizimi i OE që është shpallur fitues e bënë AK-në shkelëse të plotë të nenit 7 të LPP-së. AK na ka diskriminuar edhe kur nuk e ka shqyrtuar fare Kërkesën tonë për Rishqyrtim me aludimin se gjoja është e jashtë afatshme, edhe pse ajo është e dorëzuar brenda afatit të rregullt kohorë siç e parashihet ligji dhe rregullorja e prokurimit RRPP-001/2022. Për këtë ju njohim më detalisht në pretendimet e radhës.

Bazuar në këtë lirisht mund të themi se AK gjatë procesit të vlerësimit por edhe gjatë procesit të rishqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe në kundërshtim edhe me parimet bazë të prokurimit mbi trajtimin e drejtë dhe të barabartë të tenderuesve.

**3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së** pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka aplikuar drejtë kërkesat e përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Pika 4 e këtij neni thotë se:

**Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.**

Ne konsiderojmë se ky nen është shkelur me rastin e vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve e posaçërisht të tenderit që e ka shpallur fitues pasi që i njëjti posedon mangësi të theksuara në

tenderin e tijë. Këtë e themi sepse ky OE ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta të cilat nuk ka arritur të i saktësoj ashtu siç e kërkon ligji dhe rregullorja, nuk kishte ofruar me kohë dëshmitë e nevojshme që nuk është në vonesa ne shlyerjen e detyrimeve ndaj ATK-së dhe nuk ka paraqitur me kohë marrëveshjen me ATK-në kur AK i ka kërkuar dokumentet e përshtatshmërisë. Përpos kësaj nuk i ka paraqitur si duhet as dëshmitë për projektet e realizuara pasi që dëshmitë e ofruara nuk korrespondojnë me kërkesën e FDT-së.

Kjo tregon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 65 të LPP-së por edhe në kundërshtim të plotë me nenin 59 të LPP-së.

Si mangësi në tenderin e OE që AK e ka shpallur fitues konsiderojmë se janë referencat pasi që me referencat e paraqitura nuk janë saktë siç ishin kërkuar në FDT. Kërkesa për dëshmitë e tilla ka qenë e formuluar kështu:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<b>Kapaciteti teknik dhe profesional</b>  <b>Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës Furnizim me material elektrik, gjate 3 viteve të fundit (nga data e publikimi të Njoftimit për Kontratë), në një vlerë prej jo me pak se 135,000.00 € e në raste të themelimit të grupit, Lideri i grupit duhet të ketë 60% të vlerës të qarkullimit të cekur</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>  <b>Dëshmia 1 Kur furnizimi, shërbimi, puna është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata raporti i përkohshëm i pranimit) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë. të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar. Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë (Psh Fatura);</b>
---	-----------	--	---

Ky OE ka paraqitur disa referenca por që një pjesë e tyre janë jashtë periudhës tre vjeçare ndërsa si dëshmi nuk e plotësojnë kërkesën saktë siç e kishte kërkuar AK. E themi këtë sepse asnjëra nga to nuk është raport i pranimit me bashkë nënshkrim por janë referenca që u mungojnë disa nga karakteristikat e kërkuara nga AK në kërkesën për dëshmitë lidhur me projektet e realizuara. Kjo formë e dëshimitit bie ndesh edhe me nenin 69 të LPP-së e cila për pasoj e shtynë AK-në mandej drejt shkeljes së nenit 59 të LPP-së.

Përpos kësaj pas qasjes në dokumentet e tenderit kemi vërejtur se ky OE kishte dorëzuar vërtetimin e ATK-së por që i njëjti është me borxhe të pashlyera dhe nga ku tregohet se OE në fjalë është në marrëveshje me ATK-në. Kërkesa e AK-së ka qenë kështu:

**Dëshmia e kërkuar:** Një vërtetim te lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve dhe kontributeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës se dorëzimit të tenderit!

Bazuar në interpretimin e KRPP-së që rastet kur OE është në marrëveshje me ATK-në kjo kërkesë duhet plotësohet kështu: *(po e citojmë vetëm pjesën domethënëse)*:

**Citim nga Interpretimi nr. 6 i KRPP-së: ..... Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës.**

Nisur nga kjo dhe nisur nga fakti që ky OE nuk e ka dorëzuar me kohë marrëveshjen e tillë, pavarësisht se atë na e ka paraqitë AK me vonesë (*pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim*), dyshojmë se AK e ka futur në mënyrë të paligjshme në material dhe me që OE me kohë nuk e ka paraqitur, tregon se nuk e ka plotësuar kërkesën e AK ashtu si duhet që e bënë atë të papërgjegjshëm. Vlen të thuhet se AK ka mundur ta kërkoj atë marrëveshje por jo në këtë fazë, ajo ka mundur të kërkohe vetëm pasi ta ketë kthyes lëndën në rivlerësim. Marrë për bazë këtë, ne nuk kemi se si të mos mendojmë se AK ka shkelur plotësisht nenin 65 të LPP-së, ka shkelur kërkesën që vet e ka vendosur në FDT tek pika 6.4 si dhe nuk e ka respektuar as interpretimin 6 të KRPP-së, kur e ka vlersuar si të përgjegjshëm OE me borxhe të pashlyera duke e shpallur më pas edhe fitues.

Shkeljen e nenin 61 të LPP-së dhe shkeljen e nenit 41 të RRPP-001/2022 për mos trajtim si duhet të çmimeve jo-normalisht të ulëta si dhe shkeljen e nenit 108/A të LPP-së dhe shkeljen e nenit 42.6, dhe 42.7 të RRPP-001/2022 do ta elaborojmë tek pretendimet e radhës. Sipas krejt kësaj del që AK gjatë procesit të vlerësimit, sqarimit dhe krahasimit të tenderëve, ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së.

**4. AK ka shkelur nenit 61 të LPP-së si dhe ka shkelur nenin 41.8 dhe 41.9 të RRPP-001/2022** pasi që nuk e ka aplikuar drejt dhe si duhet sqarimin e çmimeve jo normalisht të ulëta tek OE që e ka shpallur fitues. Fillimisht po e paraqesim si duken këto dispozita:

**Neni 61**  
**Tenderët Jo-Normalisht të Ulët**

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.
2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:
  - 2.1. ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
  - 2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
  - 2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
  - 2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.
3. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.
4. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.
5. Autoriteti kontraktues është i obliguar për të njoftuar KRPP-në brenda dy ditëve që nga data e ndonjë refuzimi nën nenin paragrafit 4. të këtij neni. Njoftimi duhet të ofrojë informacionin, shpjegimet dhe arsyet e përmendura në atë nen.

Dhe ja si e kërkon këtë sqarim edhe nenin 43.8 dhe 43.9 i RRPP-001/2022:

- 41.8 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:
  - a. ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
  - b. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
  - c. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
  - d. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.
- 41.9 Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:
  - a. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.

AK nuk i ka respektuar asnjërën nga dispozitat e mësipërme pasi që përpos se nuk ka pranuar fare sqarime për çmime e kërkuara sipas nenit 41.8 dhe 41.9, AK nuk e ka përshtatur as kërkesën për sqarime të tilla sipas këtyre dispozitave. Vlen të ceket se AK ka kërkuar sqarime sipas një rregulloreje (B57) që para 4 vitesh është e shfuqizuar duke e anashkaluar rregulloren adekuatë për këtë qëllim. Mos respektimi i legjislacionit adekuat realisht konsiderohet shmangie e qëllimshme ligjore dhe ikje nga përgjegjësia e respektimit të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Kur kjo bëhet nga një zyrtarë e trajnuar dhe certifikuar, realisht mund të konsiderohet edhe element për cilësim si vepër penale.

Ja si duket kërkesa e AK-së:

**Ju lutem të sqaroni çmimin për disa nga pozicionet:**

1.28 Furnizimi i Kuadrit qendror për furnizimin e ndriçimit publik, me pjesën e gjatit shtesë nga jashtë për leximin e njehsorit, pjesën e zbratur rezerve të mbrojtur dimensionet caktohet nga AK.

- Njehësorë elektrikë 3x230/400V	1
- Ndërprerës AS-/A	1
- Transformatorë rrymorë /5 A	6
- Mikrondërprerës /A	1
- Portllampë E27	1
- Poç fluroshent 1x18w me baze	1
- Prizë OG 16 A	1
- Voltmetër Vm 0-500 V	1
- Ampermetër Am 0-200A	1
- Ndërp. Zgjedhës për Am80A-u-R10	1
- Ndërprerës tipi GS-16-66 U	1
- Sig. Tripolare automatike /A te vendosura ne kuti per 3 siguresa complete 3 ORS siguresa 9 patron /A	
- Siguresa njëpolare automatike 10-16A 6 copë schneider	
- Përçues 1x25 mm 2 (m)	50
- Kontaktorë tip CS 160 ose 100A	3
- Ndërprerësi automatik/A	1
- Rele IC Astro	1

3.14 Furnizim me trupa ndriçues fluroshent 36W

3.15 Furnizim me trupa ndriçues fluroshent 18W

3.16 Furnizim i reflektorave LED 50w dimensione të ndryshme

3.17 Furnizimi i reflektorave LED 100w dimensione të ndryshme

3.18 Furnizimi i reflektorave LED 150w dimensione të ndryshme

3.19 Furnizimi i reflektorave LED 200w dimensione të ndryshme

**Sqarim:** Sipas komisionit të vlerësimit, çmimet e cekura më lartë në ofertën Tuaj, janë shumë apo jo-normalisht të ulëta. Oferta e Juaj bie ndeshë me Rregullat për tenderët me çmime jo-normalisht të ulët.

Kërkojmë sqarime Komfor Rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët, B57 Neni 4 pika 4.4.4, citojmë: "origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara", pra duhet të na ofrohen dëshmi / asyetime bindese, si keni planifikuar ti realizoni punimet ne pozicionet e parapara.

Pavarësisht kësaj dhe gabimeve të AK-së në parashtrim të kërkesës, OE janë të detyruar çdo herë që sqarimin e çmimeve jo normalisht të ulëta ta bëjnë sipas rregulloreve në fuqi duke ofruar fakte bindëse se çmimet e tilla janë çmime reale të tregut. Kjo nuk ka ndodhur sepse OE ka ofruar vetëm një deklaratë por jo edhe fakte dhe argumente bindëse siç e kërkon ligji e sidomos dhe rregullorja RRPP-001/2022 tek nenin 41.8 dhe 43.9. Ja si duket përgjigja e tyre:

## DEKLARATË / SQARIM ZYRTAR

Nr. i Prokurimit: NPL KASTRIOTI - 261034121

Titulli: Furnizim me materiale elektrik për nevoja të ndërmarrjes - Ri-tender

Lënda: Sqarim mbi ofertën - çmime të supozuara jo-normalisht të ulëta

I nderuar,

Në përgjigje të kërkesës suaj për sqarim lidhur me ofertën tonë, përkatësisht pretendimin se çmimet janë "jo-normalisht të ulëta", ju njoftojmë si në vijim:

Çmimet e ofruara nga kompania jonë janë plotësisht reale, të bazuara në treg dhe të qëndrueshme ekonomikisht.

Ne furnizohemi drejtpërdrejt nga prodhues ndërkombëtarë (Itali, Turqi, Kinë), pa ndërmjetës lokalë, gjë që na mundëson të ofrojmë çmime më të favorshme krahasuar me operatorët që blejnë në tregun vendor.

Gjithashtu:

- Operojmë me volum të madh furnizimi
- Kemi marrëveshje direkte me prodhues
- Kemi strukturë të optimizuar të kostove

Për transparencë, jemi të gatshëm të ofrojmë:


- Dokumente doganore dhe fatura nga prodhuesit ndërkombëtarë
- Verifikim nga komision i autorizuar në depot tona

Ne i qëndrojmë plotësisht ofertës sonë dhe konfirmojmë se do ta realizojmë kontratën me përpikmëri të plotë, duke respektuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Oferta jonë është e qëndrueshme, reale dhe në përputhje me ligjin e prokurimit publik.

Me respekt,

LIRIA SH.P.K  
Agron Kopalla



Bazuar në këtë deklaratë, shihet se OE në fjalë nuk ka ofruar asnjë informatë apo sqarim bindës se si tenderues mundet të ju përmbahet çmimeve të tilla. Vlen të përmendet edhe një element me rëndësi që AK nuk ka kërkuar fare sqarim për shumë nga çmimet tjera që realisht janë edhe më shumë **jo normalisht të ulëta**. Ne këtu po e potencojmë vetëm një çmim sa për ilustrim sepse si të tilla i ka shumicën e çmimeve që i ka ofruar. Artikullin tek pozicioni 1.28 të cilin e ka ofruar **25.50€** në tregun e Kosovës me çmim të shumicës e ke së paku 110.00€ dhe atë të zbrazët pa elemente përcjellëse që AK i ka kërkuar. Ky çmim qëllimisht nuk është kontestuar sepse AK e ka ditur që s'ka shanse as teorike me u arsyetua. Ngjashëm me këtë i

ka edhe shumicën e çmimeve tjera ku një pjesë e madhe e tyre nuk përfshihen tek pozicionet që AK ka kërkuar sqarime. Nisur nga kjo dhe nisur nga forma e arsyetimit të ofruar nga OE, konstatojmë se AK nuk e ka trajtuar tenderin në fjalë ashtu si duhet dhe për pasojë ka ardhur deri tek shpallja fitues e një tenderuesi me çmime spekuluese dhe mashtruese. E themi spekulative sepse në listën e tij të çmimeve ka çmime që janë shumë të ulëta dhe ka çmime që janë shumë të larta në krahasim me tregun. Kontrata e tillë me çmime të tilla AK-së do të i kushtonte 4-5 herë më shtrenjtë dhe se ka edhe rrezik që një pjesë e konsiderueshme e artikujve të mos liferoheshin fare. Në vazhdim ne po e paraqesim një listë sqaruese nga ku mund të shihni çmimet shumë të ulëta dhe çmimet shumë të larta të këtij tenderuesi:

Nr.	Përshkrimi i Produkteve	Njësi a	Sasi a	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimet e tregut	Vërejtje
1.10	Furnizimi i pllakave për trupat ndriques LED për -100W.	copë	1	8.00 €	4.00 €	Çmim shumë i lartë
1.11	Furnizimii i pllakave për trupat ndriques LED për -150W.	copë	1	10.00 €	2.00 €	Çmim shumë i lartë
1.12	Furnizimi i trafove për trupat ndriques LED për -50W.	copë	1	8.00 €	1.50 €	Çmim shumë i lartë
1.13	Furnizimi i trafove për trupat ndriques LED për -100W.	copë	1	10.00 €	2.00 €	Çmim shumë i lartë
1.15	Furnizimii me llambadar për park	copë	1	5.00 €	12.00 €	Çmimi jo normalisht i ulët
1.16	Furnizimi i <u>siguresave</u> , automatike 16A.	copë	1	3.00 €	2.00 €	Çmim shumë i lartë
1.20	Furnizimi i <u>kabllos</u> i TIP-it PP00 <u>3x2.50mm<sup>2</sup></u> Cu të vendosura në shtylla të qeliktë të drunjëta dhe të betonit.	m'	1	3.00 €	1.50 €	Çmim shumë i lartë
1.23	Furnizimi me poça Led 40W	copë	1	8.00 €	2.00 €	Çmim shumë i lartë
1.24	Furnizimi i <u>kontaktorit</u> TIP CN 160 A si 380 V i vendosur në orman të grupit matës.	copë	1	11.00 €	18.00 €	Çmimi jo normalisht i ulët
1.25	Furnizimi i AS me shtjellim prej 100-160A. Çmim mesatar.	copë	1	15.00 €	9.00 €	Çmim shumë i lartë
1.26	Furnizimi i relese së fazave	copë	1	8.00 €	1.00 €	Çmim shumë i lartë
1.27	Furnizimi i relese IC Astrologjike, të jetë brend kualitativ.	copë	1	10.00 €	5.00 €	Çmim shumë i lartë

1.28	<p>Furnizimi i Kuadrit qendror për furnizimin e ndriçimit publik, me pjesën e gjatit shtesë nga jashtë për leximin e njehsorit, pjesën e zbratur rezerve të mbrojtur dimensionet caktohet nga AK.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njehësorë elektrikë 3x230/400V 1</li> <li>- Ndërprerës AS-/A 1</li> <li>- Transformatorë rrymorë /5 A 6</li> <li>- Mikrondërprerës /A 1</li> <li>- Portillampë E27 1</li> <li>- Poç fluroshent 1x18w me baze 1</li> <li>- Prizë OG 16 A 1</li> <li>- Voltmetër Vm 0-500 V 1</li> <li>- Ampermetër Am 0-200A 1</li> <li>- Ndërp. Zgjedhës për Am80A-u-R10 1</li> <li>- Ndërprerës tipi GS-16-66 U 1</li> <li>- Sig. Tripolare automatike /A te vendosura ne kuti per 3 siguresa komplete 3 ORS siguresa 9 patron /A</li> <li>- Siguresa njëpolare automatike 10-16A 6 copë schneider</li> <li>- Përçues 1x25 mm<sup>2</sup> (m) 50</li> <li>- Kontaktorë tip CS 160 ose 100A 3</li> <li>- Ndërprerësi automatik/A 1</li> <li>- Rele IC Astro 1</li> </ul>	copë	1	25.55 €	110.00 €	Çmimi jo normalisht i ulët
1.29	Furnizim i Lidhëseve (klema) “Unimax”, Al – Cu ose të tjerë, për vazhdimin e përçuesve në kablo, shtylla të betonit dhe të hekurit, me dimenz. të ndryshëm, dimensionet caktohet nga AK.	copë	1	3.00 €	1.80 €	Çmim shumë i lartë
1.30	Rele Kohore	copë	1	8.00 €	2.00 €	Çmim shumë i lartë
1.31	Ray Kleme 25-50 mm.	copë	1	4.00 €	2.00 €	Çmim shumë i lartë
2.2	Furnizimi i shtyllës së hekurit ndriçuese të zinguar H=9.00m, trashësia e hekurit duhet të jetë minimum 4mm, dhe gjerësia minimum Ø160 pjesa e parë, Ø120 pjesa e dytë, Ø100 pjesa e tretë dhe bazamenti i shtyllës të jetë 40x40cm trashësia e hekurit të bazamentit të jetë minimum 1cm.	copë	1	135.00 €	80.00 €	Çmimi jo normalisht i ulët
2.9	Furnizimi i unazave rreth shtyllave për përforcimin e llauderit deri në 2x16mm, gjerësia e unazës duhet të jetë minimum Ø150 - Ø1000.	copë	1	10.00 €	2.50 €	Çmim shumë i lartë
2.12	Furnizimi me rërë të imët fraksion (...2)mm në trashësi d=0.2m në kanalën e rrjetit të NP për mbrojtjen e tubit dhe kabllot.	copë	1	30.00 €	10.00 €	Çmim shumë i lartë
2.13	Furnizimi i dyerëve të ormanëve të ndriçimit publik me dimensione të ndryshme të cilat caktohen nga AK	copë	1	25.00 €	1.00 €	Çmim shumë i lartë
2.16	Furnizimi i shiritit të metalët me vrime për bulona M-6&M-8 për përforcim të trupave ndriçues në shtylla të drurit dhe betonit.	copë	1	5.00 €	1.00 €	Çmim shumë i lartë
2.17	Furnizimi i shiritit Fe Zn 25 x 4mm, lidhëseve katrore dhe materiali tjetër i nevojshëm për tokëzimin e shtyllave të hekurta dhe betonit. Komplet.	m'	1	6.00 €	1.00 €	Çmim shumë i lartë

2.20	Furnizimi me mbajtsit të lakuar (lirës) nga hekuri i zinguar, për montim në shtyllë (për shtylla të betonit) min 30 cm gjatësi	copë	1	10.00 €	5.00 €	Çmim shumë i lartë
3.14	Furnizim me trupa ndriçues fluroshent 36W	copë	1	18.00 €	4.00 €	Çmim shumë i lartë
3.15	Furnizim me trupa ndriçues fluroshent 18W	copë	1	15.00 €	4.00 €	Çmim shumë i lartë
3.32	Furnizimi i Kontaktorit CN-160A	copë	1	5.00 €	18.00 €	Çmimi jo normalisht i ulët
3.33	Furnizimi i Kontaktorit CN-250A	copë	1	6.00 €	30.00 €	Çmimi jo normalisht i ulët
3.34	Furnizimi i Kontaktorit CN-500A	copë	1	7.00 €	60.00 €	Çmimi jo normalisht i ulët
3.35	Furnizimi I Kontaktorit CN-630A	copë	1	8.00 €	80.00 €	Çmimi jo normalisht i ulët
3.36	Furnizimi I Kontaktorit CN-800A	copë	1	9.00 €	90.00 €	Çmimi jo normalisht i ulët
3.37	Furnizimi I Kontaktorit CN-1000A	copë	1	11.00 €	100.00 €	Çmimi jo normalisht i ulët
3.43	Furnizimi me ndërprerës automatik të tensionit FID për ndërprerjen e rrymës së çilerave të nxemjes dhe klimatizimit IN-100A ;50/60Hz ,Ui 690V , Uimp 8kV	copë	1	15.00 €	40.00 €	Çmimi jo normalisht i ulët
3.44	Furnizimi i ndërpresit automatik të tensionit FID për ndërprerjen e rrymës së ventilimit KP 125 IN-125A;50/60Hz ,Icu 25kA ,415V,Ta 40°C	copë	1	15.00 €	50.00 €	Çmimi jo normalisht i ulët
3.45	Furnizimi me ndërprerës automatik të tensionit FID për ndërprerjen e rrymës së ashensorit;50/60Hz ,400V	copë	1	15.00 €	50.00 €	Çmimi jo normalisht i ulët

Bazuar në krejt këtë dhe nisur nga realiteti që mbretëron me çmimet e tilla, AK është dashur të mos ja pranoj arsyetimin e ofruar pasi që i njëjti nuk e plotëson kërkesën e nenit 41.8 dhe 41.9 të RRPP\_001/2022, dhe rrjedhimisht dashur të e shpallë të papërgjegjshëm. E themi këtë sepse shumica e çmimeve siç po shihet janë çmime spekulative (disa shumë të larta e disa shumë të ulëta) që AK-së si kontratë do i kushtoj shumë shtrenjtë. Me që tenderuesit me çmim më të ulët se ne janë të papërgjegjshëm, besojmë se gjatë rivlerësimit do duhej që fitues të shpallet kompania jonë Item El SH.P.K. si tenderues i përgjegjshëm me çmime reale dhe me të ulëta në krahasim me tenderuesit tjerë të përgjegjshëm. Nisur nga edhe kërkojmë nga OSHP që pas trajtimit të ankesës tonë të aprovoj pretendimet tona të bazuara dhe lëndën ta kthej në rivlerësim.

Nga krejt kjo po shihet qartë se AK ka shkelur plotësisht nenin 61 të LPP-së dhe nen 41 të RRPP-001/2022, me rastin e përzgjedhjes së OE që edhe e ka shpallur si fitues edhe pse i njëjti realisht është i papërgjegjshëm

**5. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së** gjatë procesit të vlerësimit sepse gjatë sqarimit të tenderëve ka pranuar dëshmi të parregullta dhe që nuk i lejon neni në fjalë. Në vazhdim po paraqesim vetëm atë që e kërkon nenin 72 i LPP për sqarim të tenderëve:

**Neni 72**  
**Dokumentacioni dhe informacioni shtesë**

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.
3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Përpos kësaj kemi dyshime se marrëveshjen me ATK-në për shlyerje të borxheve me këste ja ka pranuar pasi që ne kemi parashtruar Kërkesën për Rishqyrtim. Nga krejt kjo shihet se AK nuk e ka respektuar fare nenin 72 të LPP-së.

**6. AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së** gjatë procesit të rishqyrtimit të Kërkesës tonë për Rishqyrtim ku edhe e ka cilësuar të jashtë afatshme. Kjo nuk është aspak e bazuar në ligj dhe rregullore sepse ne e kemi dorëzuar kërkesën me kohë por AK shihet se është shumë mbrapa me legjislacion dhe bazuar në sjelljet e tyre shihet se as nuk e kanë idenë se në përdorim është Rregullorja e amendamentuar, RRPP-001/2022. Fillimisht po e paraqesim një kronologji të rrjedhës së procesit.

Me datë 10.04.2026 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së. Kjo ditë ka qenë e premte. Ne me datë 15.04.2026 kemi dorëzuar kërkesën për Rishqyrtim. Kjo ditë ka qenë e mërkure. Me që dita e publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së konsiderohet si dita (0)zero e 5(pesë) ditëve të pritjes së detyrueshme atëherë dita e parë fillon në ditën e shtunë dhe mbaron të mërkurën në ora 16.00. AK e ka aplikuar nenin 5 të LPP-së por nuk e marrë për bazë që dita e njoftimeve konsiderohet ditë zero sipas rregullores së re dhe interpretimit të KRPP-së.

Ja si e arsyeton AK mos shqyrtimin e Kërkesës tonë për Rishqyrtim dhe konsiderimin e sajë si të jashtë afatshme:

**PËRGJIGJE NË ANKESËN TUAJ:**

- **Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**

(Versioni i Konsoliduar)

**Neni 5**

**Kalkulimi i afateve kohore**

- **Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune.** Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.
- Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.
- Ankesa juaj sipas afataeve kohore të parapara me Ligjin e lartecukur është bërë pas përfundimit të afatit kohor për ankesa andaj kjo ankesë nuk do të shqyrtohet.
- SQARIM (vendimi është marrë me dt:10.04.2026- e premte ku sipas ligjit mbi kalulimet e afateve kohore fillojnë në ditë pune fillon nga data e vendimit pra në ditë pune dhe kalkulohej të shtunet e të dielat dhe ditet e festes, andaj me dt:14.04.2026 në ora 16:00 ka përfunduar afati i ankesave)
- Po ju përgjigjemi vetëm të pretendimi se OE i propozuar për kontratë ku pretendoni se i mungon marrëveshja me ATK dhe pagesat sipas marrëveshjes nuk qëndron sepse OE me kohë i ka dërguar në sistemin e e-prokurimit dhe i ka sjell edhe origjinalet.(duhni me pas në dosje në USB kur keni marrë qasjen në dokumente) ,por sa për korrektesë po ju dërgoj edhe një herë përmes e-prokurimit marrëveshjen me ATK dhe pagesat e realizuara për të gjithë OE

Ankesa e OE nuk është në përputhje me kërkesat e AK dhe në këtë rast kërkesa për

**RI-SHQYRTIM është e PABAZUAR.**

Se kjo çfarë ka konstatuar AK është plotësisht jo profesionale dhe për më keq edhe jo ligjore, po ju bashkëngjisim interpretimin si të shkëputur të KRPP-së si dhe paraqitjen vizuale të asaj që e thotë edhe rregullorja tek nenin 42 dhe 60 i sajë:

**35. 04.12.2023 Si të kalkulohej afati kohor për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së?**

2. Në përputhje me nenin 60.1, b) të RRPP Në rast se AK ka publikuar në platformën elektronike të prokurimit publik **B58 "Njoftimin mbi Vendimin e AK-së"**, data e publikimit të këtij njoftimi është dita "zero" e pesë (5) ditëve për parashtrimin e një Kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Për shembull: Nëse B58 "Njoftimi mbi vendimin e AK-së" është publikuar me datë 20.10.2023 para orës 16:00. Afati fillon të kalkulohej nga dita e nesërme e publikimit: 21. 22. 23. 24. 25 dhe rrjedhimisht afati i fundit për të parashtruar Kërkesën për rishqyrtim është data 25.10.2023 deri në ora 16:00. Pra nëse AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e AK-së në ditën e premte, dita e premte është dita "0" e pesë (5) ditëve për Kërkesë për rishqyrtim në AK. Pra afati i fundit për të parashtruar kërkesën është dita e Mërkurë deri në ora 16:00.

**Neni 42**  
**Njoftimi i Tenderuesve / Kandidatëve**

42.1 Të gjithë tenderuesit/kandidatët, duhet të informohen nga AK, përmes publikimit të Formularit B58 “Njoftimit mbi Vendimin e AK”.

42.5 Data e publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK, respektivisht njoftimit të tenderuesve/kandidateve përbën:

- a. Datën kur të gjitha informatat në lidhje me aktivitetin e prokurimit (përveç informatave sekrete të biznesit) janë në dispozicion për palët e interesit.

42.6 Data e njoftimit të tenderuesve/kandidateve është “dita 0” e 5 ditëve të obligueshme të periudhës “në pritje”.

42.7 Nëse njoftimi publikohet në ditën e premtë, afati kohor për parashtrim të ankesës fillon ditën e premtë sepse:

- a. Dita e premtë është ditë pune.
- b. Në përputhje me Nenin 60, paragrafi (b) të kësaj rregullore, data e njoftimit është “dita 0” e 5 ditëve


**Neni 60**

**Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore**

60.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

- a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.
- b) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0).

Nga kreu kjo po shihet qartë se AK nuk ka respektuar aspak afatet kohore të përcaktuara me ligj dhe rregullore, dhe në kundërshtim me to edhe ka vendosur padrejtësisht që të e trajtoj kërkesën tonë si të jashtë afatshme. AK ka theksuar se gjoja bashkë me ATK OE LIRIA ka sjellur edhe marrëveshjen me ATK dhe kinse ato na i ka dhënë përmes USB-së. Kjo nuk qëndron dhe se është e pasaktë pasi që ajo nuk ndodhet bashkë me vërtetimin e ATK dhe si duket atë AK e ka pranuar pas parashtrimit të Kërkesës tonë për Rishqyrtim. Ja çka kemi pranuar me USB nga AK:



Pra edhe kjo që ka theksua në raport me marrëveshjen e ATK-së nuk qëndron dhe rrjedhimisht arsyetimi i tyre është plotësisht i pabazuar. Ne i kërkojmë ekspertit që ta verifikoj se kur e ka dorëzuar ky OE këtë marrëveshje sepse po ta kishte dorëzuar me kohë AK do na e paraqiste.

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdes ankesën tonë kundër vendimit të AK-së dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar, duke marr:

## V E N D I M

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e OE “**Item EL SH.P.K.**” lidhur me tenderin “**Furnizim me materiale elektrik për nevojat të ndërmarrjes-Ri-tender**”.

**ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK – **NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A.** dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

**Ri-vlerësimi** të bëhet plotësisht bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në detyrimet e LPP-së, e që realisht më pas do duhej që **Fitues** të shpallej OE “**Item EL SH.P.K.**”.














### **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

-  1 Njoftim per Kontrat
-  2 Template per Dosja e Tenderit -shqip
-  3 Paramasa-shqip-Furnizim me material elektrik për nevoja të Ndermarrjes-Ri-tender
-  4 Proces verbali i hapjes se Tenderve
-  5 Njoftim për vendimin e AK 10.04.2026
-  6 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit Liria
-  7 Pergjigja ne kerkes e AK Kastrioti ne kapacitetin teknik porfesional
-  8 Leter Standarde e kerkeses per informata mbi tendert jo-normalisht te ulet-Liria
-  9 Deklarta e Qmimeve
-  10 VertetimTatimor Liria 27.03.2026
-  11 Paramasa-Furnizim me material elektrik - LIRIA
-  12 Kërkesë për rishqyrtim - Item EL SHPK - 15.04.2026
-  13 Pergjigje ne kerkesen e OE Item El sh.p.k

***Vërejtje:*** Të gjithë materialin në të cilin i kemi mbështetur pretendimet e gjeni të bashkangjitur ndërsa ofertën tonë e gjeni në materialin e procedurës së prokurimit që ndodhet në e-Prokurimit!